



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

VENDIM

Nr. 703, datë 29.10.2014

PËR

AGJENCINË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, më poshtë AKSHI, është institucion publik qendror, person juridik, me seli në Tiranë, dhe financohet nga buxheti i shtetit e të ardhura të tjera të ligjshme.

2. AKSHI ka objekt të veprimtarisë:

- a) ofrimin e shërbimeve të përqendruara on-line për qytetarët përmes teknologjisë së informacionit e komunikimit (TIK) për qeverisjen elektronike;
- b) zbatimin e politikave e të strategjive për zhvillimin e sektorit të shoqërisë së informacionit (më poshtë SHI) dhe në veçanti të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (më poshtë TIK);
- c) bashkërendimin e programeve në fushën e SHI-së dhe në veçanti të TIK-ut;
- ç) nxitjen e investimeve në fushën e SHI-së;
- d) promovimin e teknologjive të reja në fushën e SHI-së;
- dh) dhënie të kontributit në edukimin dhe nxitjen e përdorimit të TIK-ut nga publiku.

3. AKSHI ka këto detyra dhe përgjegjësi specifike:

a) Bashkërendon planin e veprimit të strategjisë së shoqërisë së informacionit për ofrimin e shërbimeve on-line të administratës publike.

b) Ofron shërbimet e përqendruara të TIK-ut për administratën publike, përfshirë shërbimet e autentifikimit dhe nënshkrimit elektronik.

c) Përcakton standardet e TIK-ut, bazuar në standardet ndërkombëtare dhe evropiane, të adoptuara, që do të ndiqen nga administrata shtetërore. Këto standarde botohen në Buletinin e Njoftimeve Publike.

ç) Bashkërendon projektet në fushën e SHI-së, që zbatohen në të gjitha institucionet publike.

d) Me qëllim zbatimin efektiv dhe bashkërendimin e projekteve në fushën e TIK-ut, organet dhe institucionet e administratës shtetërore:

i) për projektet ekzistuese dhe/ose të reja për sistemet e TIK-ut që ata duhet të projektojnë, të zhvillojnë dhe/ose të hostojnë, kërkojnë nga AKSHI projektimin dhe zbatimin e tyre, përfshirë aplikacionet dhe pajisjet TIK, mirëmbajtjen, si dhe ofrimin e trajnimeve përkatëse për to;

ii) në të gjitha rastet e tjera, marrin mendimin e AKSHI-t për:

- specifikimet teknike të prokurimeve, të realizuara me fonde të buxhetit të shtetit, hua dhe/ose grante të dhëna nga donatorë;
- procedurat që kanë lidhje me projekt-propozime/projekte të ndryshme, dhurata apo ndihma materiale.

AKSHI jep mendim brenda afatit prej 20 ditësh pune nga data e marrjes së dokumentacionit të sipërpërmendur.

dh) Zhvillon, administron dhe mirëmban infrastrukturën e shërbimeve të qeverisjes elektronike, e cila përbëhet nga:

- Portali unik qeveritar e-albania, platforma qeveritare e ndërveprimit për ofrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike, sipas tipologjisë: qeveri - qeveri, qeveri - qytetar, qeveri - biznes;

- Regjistri Kombëtar i Shërbimeve Qeveritare on-line;

- Regjistri Kombëtar i Bazave të të Dhënave Shtetërore;

- Qendra e të dhënave qeveritare (Datacenter-in qeveritar);

- Qendra e rivendosjes dhe/ose vazhdueshmërisë së punës së datacenter-it qeveritar, në rast fatkeqësie (Disaster Recovery Center);

- Qendra e vazhdueshmërisë së punës (“Business Continuity Center”, BCC) dhe qendra e ruajtjes së informacionit (Back-up Center) me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimeve pa ndërprerje 24 orë në 24 orë për 7 ditë të javës;
- Rrjeti qeveritar (Govnet);
- Çelësi publik dhe menaxhimi i certifikatave digjitale për administratën publike. Me garancinë financiare si institucion qeveritar, AKSHI siguron pajtueshmërinë me nenin 19, të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik;
- Sistemi i administrimit të dokumentit elektronik, përfshirë protokollin dhe arkivin elektronik.
- Sistemi i administrimit të dokumentit elektronik, përfshirë protokollin dhe arkivin elektronik.

e) Rregullon dhe koordinon bazat e të dhënave shtetërore në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

ë) Merr pjesë në hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit dhe bashkërendon punën për zbatimin e saj.

f) Merr pjesë në hartimin e dokumentit të politikës së zhvillimit në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare.

g) Merr pjesë në përgatitjen e bazës ligjore për zhvillimin e SHI-së dhe të TIK-ut.

gj) Ndiemon në hartimin e ndryshimeve dhe përmirësimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare.

h) Mbështet dhe bashkërendon projektet për digjitalizimin e bazës ligjore, të dokumentacionit, të arkivave, të bibliotekave etj.

i) Nxit dhe mbështet zhvillimin e biznesit on-line (e-bussiness).

j) Nxit dhe mbështet politika për zhvillimin e infrastrukturës së TIK-ut dhe të investimeve private në këtë fushë.

k) Promovon përhapjen e internetit dhe aksesin e publikut në shërbimet on-line.

l) Promovon dhe mbështet rritjen e aftësive për përdorimin e kompjuterit dhe të internetit nga qytetarët.

ll) Bashkëpunon në fushën e SHI-së me institucione të tjera shtetërore dhe ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe sektorin privat.

m) Mbështet ministrin përgjegjës për komunikimet elektronike dhe postare në hartimin e praktikave sipas ligjit për komunikimin elektronik dhe postar si dhe bashkërendon veprimtarinë e përgatit praktikave në kuadër të detyrimeve,

konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, dypalëshe dhe shumëpalëshe, në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare.

4. Ministria përgjegjëse për investimet, gjatë planifikimit të projektbuxhetit të shtetit, duhet të marrë mendimin e AKSHI-t, i cili është organ teknik-këshillimor i institucioneve të përmendura në shkronjën “ç”, të pikës 4, të këtij vendimi, për kërkesat e tyre, për financimin me fonde buxhetore të projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

5. AKSHI drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie.

6. Drejtori i Përgjithshëm i AKSHI-t emërohet, lirohet ose shkarkohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit.

7. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të kësaj agjencie rregullohen me Kodin e Punës.

8. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, e krijuar me vendimin nr. 248, datë 27.4.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, të ndryshuar, vazhdon funksionimin me miratimin e këtij vendimi.

9. Struktura dhe organika e AKSHI-it, të miratuara sipas vendimit nr. 248, datë 27.4.2007, të Këshillit të Ministrave, mbeten në fuqi deri në miratimin e strukturës dhe organikës së re sipas këtij vendimi.

10. Drejtori i Përgjithshëm i AKSHI-t, i emëruar sipas vendimit nr. 248, datë 27.4.2007, të Këshillit të Ministrave, vazhdon detyrën me miratimin e këtij vendimi.

11. Vendimi nr. 248, datë 27.4.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, të ndryshuar, shfuqizohet.

12. Ngarkohen Kryeministria, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministria e Financave dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

13. Në lidhjen nr. 1, që përmendet në pikën 3, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ndarja me numër rendor 18 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama